

**AKT THEMELIMI**  
**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**" ALB - DRIL" SH.P.K.**

Ne Fier, sot ne date 07.08.2018:

- **Petrit Dogani**, atesia Fejzi, i datelindjes 30.04.1974 , lindur ne Zharrez, Fier dhe banues në Sheqishte, Fier, shtetas shqiptar, madhor, me zotësi juridike dhe për te vepruar, mbajtes i Leternjoftimit nr. 029459142 dhe numer personal H40430020D, dhe
- **Ermal Dogani**, atesia Qemal, i datelindjes 16.05.1990 , lindur ne Fier dhe banues në Sheqishte, Fier, shtetas shqiptar, madhor, me zotësi juridike dhe për te vepruar, mbajtes i Leternjoftimit nr. 028918540 dhe numer personal I00516035E.

me cilësinë e "Ortakeve themelues" kane redaktuar këtë akt themelimi, për krijimin e një shoqërie me përgjegjësi te kufizuar me emërtimin "ALB - DRIL" Sh.p.k. në respektim te Kushtetutës se Republikës se Shqipërisë, Kodit Civil ne fuqi, ne ligjit 9901, date 14.04.2008, " Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, "Për Qendrën Kombëtare te Regjistrimit".

**Neni 1 - Krijimi**

Shoqëria "ALB- DRIL" sh.p.k, është person juridik i te drejtës shqiptare, Shoqëri me përgjegjësi te kufizuar (me poshtë e quajtur "Shoqëria").

**Neni 2 - Objekti i veprimtarisë**

Objekti i veprimtarisë se shoqërisë do te jete:

- Kryerjen e punimeve per shpim gurore , shkembore, rrugeshe , autostradash etj, si dhe kryerjen e shperthimeve me lende plasese.

Përshkrimi i objektit te shoqërisë ka natyre indikuese dhe jo kufizuese. Për realizimin e qëllimit te saj shoqëria mund te bashkëpunojë me çdo person fizik apo juridik ne çdo mënyrë qe e gjykon te dobishme.

Shoqëria ne çdo kohe mund te ripërcaktojë objektin e saj, ta shtoje apo pakësojë atë, me vendim te asamblesë se shoqërisë.

**Neni 3 - Selia**

Shoqëria e ka selinë ligjore në Rr. "Petraq Poshnjari" Sheqishte , Bashkia Patos, Fier , Pas. me nr. 114/20-ND, ZK. 3361, dhe e zhvillon aktivitetin e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë .



Shoqëria e zhvillon veprimtarinë e saj në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë këtij territori, duke hapur zyra apo degë ose nëpërmjet veprimtarive të kryera në përputhje me misionin dhe statutin e shoqërisë si dhe legjislacionin në fuqi.

#### **Neni 4 - Kohëzgjatja**

Afati i veprimtarisë së saj do të jetë mbi dhjetë vjet, duke filluar nga data e regjistrimit në Regjistrin Tregtar Shqiptar, pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

Ky afat mund të zgjatet dhe mund të shkurtohet në rastet kur shoqëria do të snpërbenet sipas përcaktimeve që pasqyrohen në statut.

#### **Neni 5 - Kapitali themeltar**

Kapitali shoqëror fillestar është 100 000 lekë (njëqind mijë leke).

Krijohet me mjetet financiare prone e ortakeve PETRIT DOGANI dhe ERMAL DOGANI në masën 100%, në shumën prej 100 000 LEKE (NJEQINDMIJE) leke, ku secili prej ortakeve zoteron këte përqindje të kuotave të kapitalit:

- **PETRIT DOGANI** zoteron 50 % të kapitalit në shumën 50 000 leke (pesedhjetë mijë leke) të shprehur në një kuotë .
- **ERMAL DOGANI** zoteron zoteron 50 % të kapitalit në shumën 50 000 leke (pesedhjetë mijë leke) të shprehur në një kuotë

#### **Neni 6 - Organet e shoqërisë**

Asambleja e Ortakeve

Administratori.

Kompetencat, të drejtat dhe detyrimet e secilit prej organeve të shoqërisë janë të parashikuara me gjerësisht në statutin e shoqërisë.

#### **Neni 7 - Asambleja e Ortakeve**

1. Të drejtat e ortakeve, për çështjet e lidhura me veprimtarinë e funksionimin e shoqërisë, ushtrohen nëpërmjet asamblesë së përgjithshme e përbërë nga ortaket e saj.

2. Asambleja e përgjithshme merr vendime për çështjet e mëposhtme të shoqërisë:

- a) përcaktimin e politikave tregtare;
- b) ndryshime të statutit;
- c) emërimin e shkarkimin, revokimin e administratorit;
- ç) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) miratimin e skemës së shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" e "ç" të kësaj pike;
- dh) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) shpërndarjen e fitimeve vjetore;
- ë) zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar;
- gj) përfaqësimin e shoqërisë në gjykimet ndaj organeve të administrimit;
- h) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- i) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të saj;

j) çështje të tjera të parashikuara shprehimisht nga ligji apo statuti.

3. Asambleja e përgjithshme merr vendime pas shqyrtimit të dokumenteve përkatëse, së bashku me raportin e administrimit dhe raportin e ekspertit kontabël të autorizuar.

4. Pavarësisht nëse shoqëria zotërohet nga një apo shumë ortakë, të drejtat dhe detyrimet e asamblesë së përgjithshme ushtrohen nga çdo ortak. Të gjitha vendimet e marra nga ortakët regjistrohen në një regjistër të vendimeve. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet e mëposhtme:

- a) miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) shpërndarja e fitimeve vjetore dhe mbulimi i numbjeve;
- c) zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit;
- ç) vendimet për investime;
- d) riorganizimi dhe prishja e shoqërisë.

### **Neni 8 - Administrimi**

Emërimi i Administratorit të shoqërisë është kompetence e Asamblesë së Ortakeve dhe administratori i parë i shoqërisë për një afat 5 (pese) vjeçar do të jetë:

- **Petrit Dogani**, i datelindjes 30.04.1974, lindur në Zharrez, Fier dhe banues në Sheqishtë, Fier, shtetas shqiptar, madhor, me zotësi juridike dhe për të vepruar, mbajtes i Leternjoftimit nr. 029459142 dhe numer personal H40430020D.

Administratori i shoqërisë ka të drejtë të ushtroje detyrat dhe kompetencat e mëposhtme:

- a) të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë;
- b) të përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) të kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) të përgatisë dhe të nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, për t'u paraqitur më pas për miratim nga asambleja e përgjithshme;
- d) të krijojë një sistem monitorimi e njoftimi të hershëm për rrethanat, që kërcënojnë ekzistencën e shoqërisë;
- dh) të kryejë regjistrimet e publikimet e detyrueshme të të dhënave të shoqërisë, sipas parashikimeve të këtij ligji apo të ligjeve të tjera;
- e) të raportojë përpara asamblesë për zbatimin e politikave tregtare dhe, me realizimin e veprimeve me rëndësi të veçantë, për veprimtarinë e shoqërisë;
- ë) të kryejë detyra të tjera, të përcaktuara në ligj dhe në statut.

### **Neni 9 - Shkrirja dhe likuidimi**

Përveç rasteve të parashikuara nga ligji, Mbledhja e Jashtëzakonshme e Asamblesë së Ortakeve, mund të vendosë shkrirjen e parakohshme të shoqërisë dhe vënien e saj nën likuidim.

Për këtë qëllim, Mbledhja e Jashtëzakonshme e Asamblesë së Ortakeve, do të

përcaktojë procedurat dhe mënyrat e likuidimit, duke zbatuar dhe respektuar ato ç'ka janë parashikimet e ligjit.

Mbledhja e Jashtëzakonshme e Asamblesë se Ortakeve, emëron një a me tepër likuidues, duke përcaktuar për secilin kompetencat dhe funksionet ne kryerjen procedurave te likuidimit.

### **Neni 10 - Baza Ligjore**

Shoqëria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne përputhje te plote me këtë akt themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet ne këtë akt themelimi, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik ne Republikën e Shqipërisë.

### **Neni 11 - Dispozita përfundimtare**

Ngarkohet Administratori i shoqërisë te kryeje procedurat e regjistrimit fillestar te shoqërisë.

Ky akt themelimi u redaktua ne 4 (katër) ekzemplare me përmbajtje dhe vlera te njëjta juridike, ne gjuhen shqipe dhe pasi miratohet ne parim dhe nen për nen nënshkruhet ne të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmën origjinale.

### **ORTAKET E SHOQËRISË**

PETRIT DOBANI



Ermed Dagan

